



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “MARKETING & DISTRIBUTION” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J72124001N**, me seli: *Tiranë, Kashar, KASHAR, Autostrada Tiranë - Durrës, Km.10.*

Procedura e prokurimit: **“E Hapur e Thjeshtuar- Mallra”**, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: **REF-61529-03-06-2023**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje kancelari”**, me fond limit në vlerën: **1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekë pa TVSH**, nga grandi në vlerën: 720 000 (shtatëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat në vlerën: 380 000 (treqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, me afat realizimi: **10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 24, datë 13 Mars 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “Adenis Kastrati” P. Fizik, me numër Nipt-i: **L51611004I**

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

2. Operatori Ekonomik: “INFINITI OFFICE” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L51420007C**

Vlera: 1 084 847 (një milion e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik: “InfoSoft Office” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J62426002Q**

Vlera: **897 816.9** (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë nëntë) **lekë pa TVSH.**

4. Operatori Ekonomik: “LIBRARI DYRRAHU” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L91418502J**

Vlera: **930 000** (nëntëqind e tridhjetë mijë) **lekë pa TVSH.**

5. Operatori Ekonomik: “MARKETING & DISTRIBUTION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J72124001N**

Vlera: **926 151** (nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e një) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Operatori Ekonomik: “Adenis Kastrati” P. Fizik,** me numër Nipt-i: **L51611004I.**
- 2. Operatori Ekonomik: “INFINITI OFFICE” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L51420007C.**
- 3. Operatori Ekonomik: “InfoSoft Office” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **J62426002Q.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, subjekti “Adenis Kastrati” P. Fizik, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “b” dhe “c”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:...

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1* dhe *Listën e Çmimeve të Artikujve sipas Shtojcës 2* nuk ka përcaktuar çmimin total të ofertës dhe çmimet për listën e artikujve objekt prokurimi, si dhe nuk ka paraqitur *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.***

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Referuar vlerës, cilësisë dhe sasisë të konsiderueshme që kanë disa artikuj objekt prokurimi, me qëllim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor mostrat për artikujt/mallrat e mëposhtëm:

1. *Bojë printeri Canon MF3010*
2. *Bojë printeri Kyocera FS 6525 MFP*
3. *Letër format A4 (1 rizëm)*

▪ ***Mosdorëzimi i mostrës së kërkuar përbën shkak për s'kualifikim.***

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi nuk ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostrat për artikujt/mallrat e kërkuar.**

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “INFINITI OFFICE” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “a” dhe “c”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit*, nuk është plotësuar saktë (*klikuar alternativa*) në pikën 6 të Seksionit B “*Deklarata për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura*”, si dhe nuk ka paraqitur *Listën e Çmimeve të Artikujve sipas Shtojcës 2*, dokument i cili është pjesë e Ofertës Ekonomike.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.2/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se Bilancet vjetore për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021 nuk janë të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në vërtetimin e paraqitur për vërtetimin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, nuk jepen të dhënat e kërkuara për vlerën e kontratës së realizuar dhe afatin e përfundimit të saj.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

2.3.4 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se Tonerat janë në konformitet të plotë sipas tipit të printerit/ fotokopjes.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi nuk është paraqitur deklarata e kërkuar si më lart, për konformitetin e tonerave sipas tipit të printerit/ fotokopjes.**

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “InfoSoft Office” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:...

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur Listën e Çmimeve të**

Artikujve sipas Shtojcës 2 në mënyrë të plotë (me të gjithë artikujt objekt prokurimi) dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqërisë, dokument i cili është pjesë e Ofertës Ekonomike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“MARKETING & DISTRIBUTION”** Sh.p.k., me seli: *Tiranë, Kashar, KASHAR, Autostrada Tiranë - Durrës, Km.10*, me numër Nipt-i: **J72124001N**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **926 151 (nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: *Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **930 000 (nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Titullari i Autoritetit Kontraktor